



KOLEGJI AAB – KAMPUSI PRISHTINË  
FAKULTETI EKONOMIK  
Kërkesa i drejtohet: Dekanatit

**Programi për Studimet: Master**

**Emri i plotë i programit të studimit: MARKETING DHE MENAXHIM BIZNESI**

**Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës, tezat dhe projekt për temën e diplomës**

**Kandidati: ARIAN DACI nga PRISHTINA**

**Titulli i Temës:**

Aplikimi i promocionit në sigurimin e jetës nga kompanitë e sigurimit në Kosovë

**Propozimi për mentor: SHAIPI BYTYQI**

**Përshkrimi i shkurtër i temës:**

Sigurimet janë një mjet shumë i efikas përmes të cilit njerëzit mund të kontrollojnë humbjet e tyre financiare, çofshin ata persona fizik apo juridik. Pra sot sigurimet nuk janë diçka tabu, por ato janë një nevojë, për një të ardhme më të sigurtë. Në Kosovë sot ekziston një treg mirë i konsoliduar i sigurimeve, i cili ka kapacitete të mjaftueshme të ofrojë sigurime të cilat janë të nevojshme, për të mbrojtur qytetarët e Kosovës dhe bizneset e tyre nga ndodhi të ndryshme qofshin ato fatkeqësi natyrore apo tjera, e të cilat do të mund të shkaktonin dëme të konsiderueshme financiare. Dhe për të mos u përballur me situata të tilla, në rast të fatkeqësive natyrore apo edhe fatkeqësive tjera, ku humbjet financiare do të ishin të paparashikueshme, krejt çka duhet të bëjmë është të kemi një qasje më serioze për të ardhmen dhe të papriturat të cilat mund të na sjell ajo. Tani kemi dy lloj sigurimesh, Sigurimet e detyrueshme dhe ato vullnetare. Sigurimi i jetës është një lloj sigurimi vullnetar. Polica e sigurimit të jetës, ju siguron dhe njëkohësisht ju ofron mundësinë për të kursyer. Pas mbarimit të kontratës së sigurimit apo në rast të vdekjes, shumica e siguruar së bashku me fitimin e pritur gjithmonë i paguhet përfituesit. Si sigurim shtesë e kontratës së sigurimit të jetës mund të kontraktohet edhe sigurimi nga pasojat e aksidentit (Sigurim në rast të invaliditetit të përhershëm si pasojë e aksidentit, vdekja nga aksidenti, shpenzimet mjekësore dhe pagesa ditore spitalore).